

FLETA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Sika® Patch-5

LLAÇ STRUKTUROR ME 1 PËRBËRËS, MPIKSJE DHE NGURTËSIM TË SHPEJTË, I PËRFORCUAR ME FIBRA, PËR APLIKIM ME DERDHJE (SCC) PËR RIPARIME LOKALE MBI DYSHEME DHE ELEMENTE PREJ BETONI.



PËRSHKRIMI I PRODUKTIT

Sika® Patch-5 është llaç çimentoje me 1 përbërës, me mpiksje dhe ngurtësim të shpejtë dhe konsistencë SCC (self compacting concrete, beton i vetëkompaktueshëm) për riparime lokale të dyshemeve dhe elementeve prej betoni. Konsistenca mund të adaptohet duke reduktuar sasinë e ujit, për të bërë produktin më të përshtatshëm për aplikime në pjerrësi.

PËRDORIMET

- I përshtatshëm për punime restaurimi (Parimi 3, Metoda 3.1 & 3.2, EN 1504-9:2008). Riparim i betonit të copëtuar dhe dëmtuar në ndërtesa, ura, vepra infrastrukturore dhe superstrukturore.
- I përshtatshëm për përforsim të strukturës (Parimi 4, Metoda 4.4 e 1504-9:2008). Rritje e kapacitetit bartës të strukturës së betonit me shtim llaçi;
- I përshtatshëm për ruajtje apo restaurim të pasivitetit (Parimi 7, Metoda 7.1 & 7.2 e 1504-9:2008). Rritje e mbulimit me beton shtesë ose zëvendësim të betonit të ndotur apo të karbonuar;
- Sika® Patch-5 mund të përdoret për riparime lokale mbi dysheme industriale betoni në mjedise të brendshme e të jashtme, fugat e rrugëve, kapakët e pusetave dhe në përgjithësi për riparimin e elementeve prej betoni ku kërkohet tharje e shpejtë dhe rezistencë e lartë ndaj abrazionit dhe ku ndërprerja e shërbimit duhet të minimizohet.

KARAKTERISTIKA / AVANTAZHE

- Maturim dhe ngurtësim i shpejtë
- Konsistencë SCC (self-compacted concrete, beton i vetëkompaktueshëm) me teknologjinë Sika® ViscoCrete®
- Përzierje shumë e lehtë
- Rezistencë shumë e lartë ndaj abrazionit, Kategoria AR 0.5 me metodën BCA
- Punueshmëri shumë e mirë
- Tkurrje shumë e ulët
- Konsistencë e adaptueshme

INFORMACIONE MBI MJEDISIN

- Pajtueshmëri me LEED v4 MRc 2 (Opsioni 1): Zbulimi dhe optimizimi i produkteve të ndërtimit – Deklarimet e produktit për mjedisin

MIRATIME / STANDARDE

- Sika® Patch-5 plotëson kërkesat për performancë të kategorisë R4 të EN 1504-3:2005; DoP nr. 28092242; certifikuar nga Organi i Kontrollit të Prodhimit në Fabrikë: 0546; certifikatë 18774 dhe mbart markën CE.
- Sika® Patch-5 plotëson kërkesat për performancë të kategorisë CT-C70-F7-AR0,5 of EN 13813:2002; DoP nr. 65918587; mbart markën CE.

INFORMACIONE MBI PRODUKTIN

Baza kimike	Llaç çimentoje i përforcuar me fibra, me tym silici (silica fume).
Ambalazhi	Thes i parafabrikuar 25 kg
Paraqitja / Ngjyra	Pluhur çimentoje, gri e errët.
Jetëgjatësia	12 muaj nga data e prodhimit
Kushtet e magazinimit	Të ruhet në ambalazhin origjinal të mbyllur, në përputhje me kërkesat e zakonshme të magazinimit të produkteve me bazë çimentoje.
Dendësia	Dendësia e thatë e dukshme: 1.39 ± 0.05 kg/L Dendësia e llaçit të freskët: ~ 2,23 kg/L (UNI 8995)
Përmasa maksimale e kokrrizës	D _{max} = 4.5 mm
Përmbajtja në jone të tretshme kloruri	≤ 0.05% (EN 1015-17)

TË DHËNA TEKNIKE

Rezistenca ndaj ngjeshjes	Kategoria R4	(EN 1504-3)			
	Kategoria C70	(EN 13813)			
	~ 70 MPa	(EN 12190)			
		Në + 5°C	Në + 10°C	Në + 20°C	(UNI 196-1)
	1 orë	-	-	~ 14 MPa	
	2 orë	~ 4 MPa	~ 19 MPa	~ 30 MPa	
	4 orë	~ 26 MPa	~ 30 MPa	~ 45 MPa	
24 orë	~ 45 MPa	~ 47 MPa	~ 48 MPa		
7 ditë	-	-	~ 60 MPa		
Moduli i elasticitetit në ngjeshje	~ 32.6 GPa	(EN 13412)			
Rezistenca ndaj tërheqjes në përkulje	Kategoria F7	(EN 13813)			
	~ 9.6 MPa	(UNI 196-1)			
Rezistenca e ndërkapjes në tërheqje	~ 2.5 MPa	(EN 1542)			
Rezistenca ndaj abrazionit	AR0,5 (~ 33 µm)	(EN 13892-4)			
Kompatibiliteti termik	Ngrirje - shkrirje (50 cikle) > 2 MPa	(EN 13687-1)			
Reagimi ndaj zjarrit	Euroclass A1	(EN 13501-1)			
Absorbueshmëria kapilare	~ 0.48 kg m ⁻² h ^{-0.5}	(EN 13057)			
Hyrja e joneve të klorureve	~ 0,055%	(EN 13396)			
Rezistenca ndaj karbonimit	Kalon	(EN 13295)			

INFORMACIONE PËR APLIKIMIN

Raporti i përzjerjes	Nevojitet 12 ÷ 14% ujë (3.0 L ÷ 3.5 L për thes 25 Kg). Për aplikime në pjerrësi, sasia e ujit mund të reduktohet deri në 10% (2.5 L për thes 25 Kg).
Konsumimi	~ 2.0 kg pluhur për miks 1L
Trashësia e shtresës	Min. 15 mm / max. 50 mm.

Konsistenca	~ 280 mm (W/P 13%)	(EN 1015-3)	
	~ 89 cm*	Fillestare	koni Abrams (EN 206)
	~ 85 cm*	Pas 20 min.	koni Abrams
	* Test i kryer në +20°C me raport ujë/pluhur 13%		
Temperatura e produktit	+ 5°C min / + 30°C max		
Temperatura e mjedisit	+ 5°C min / + 30°C max		
Temperatura e nënshtresës	+ 5°C min / + 30°C max		
Koha e punueshmërisë	Temperaturat	Koha	
	+ 10°C	~ 30 minuta	
	+ 20°C	~ 20 minuta	
	+ 30°C	~ 20 minuta	

UDHËZIME APLIKIMI

CILËSIA E NËNSHTRESËS / PËRGATITJA

Përgatitni dyshemenë duke hequr pjesët e lira, pislleqet, vajin dhe grason, etj. për të përfunduar një nënshtresë të pastër dhe të qëndrueshme. Sipërfaqet e dyshemeve duhe të bluhën përpara aplikimit të Sika® Patch-5. Lagni paraprakisht sipërfaqen, sipërfaqja nuk duhet lejuar të thahet përpara aplikimit të llaçit për riparimin e betonit. Sipërfaqja duhet të arrijë një paraqitje mat të errët pa shkëlqim dhe porët ose vrimat nuk duhet të përmbajnë ujë. Nënshtresa duhet të përgatitet me teknika të përshtatshme përgatitjeje mekanike, si pastrimi me ujë me presion të lartë ose fryrje/ përpunim me rrymë rëre. Preferohen metoda pastrimi pa vibrim. Agregatet duhet të duken qartësisht mbi sipërfaqen e zonës së përgatitur. Skajet e zonës së ndikuar nga ndërhyrja duhet të priten në mënyrë përpjendikulare (90 gradë) deri në thellësi minimale prej 5 mm. Lagni sipërfaqen deri në saturim. Sipërfaqja duhet të arrijë një paraqitje mat të errët pa shkëlqim dhe porët ose vrimat nuk duhet të përmbajnë ujë.

PËRZIERJA

Hidhni gradualisht pluhurin tek uji i përzierjes. Përzierja mirë për të paktën 3 minuta për të përfunduar një llaç plotësisht homogjen. Përzierja duhet bërë me një përzierës në shpejtësi të ulët ose përzierës për llaçet, preferohet me aks vertikal, duke u kujdesur për të mos bllokuar ajrin tek miksi. Përdorni të gjithë thesin e Sika® Patch-5 për përzierjen, shmangni përzierjen e pjesshme e cila mund të shkaktojë shpërndarje jo homogjene të agregateve dhe fibrave.

APLIKIMI

Hidhni menjëherë mbi nënshtresën e lagur mat ose brenda kallëpit të përgatitur për derdhjen. Nuk nevojitet kompaktim, për shkak të konsistencës së vetëkompaktueshme të betonit. Thjesht derdhni materialin për të mbushur të gjithë hapësirën. Përdorimi i më shumë se një përzierësi në të njëjtën kohë, lejon gjithnjë punën me material të freskët mbi të freskët dhe redukton fugat.

MIRËMBAJTJA E MJETEVE

Pastroni të gjitha veglat dhe pajisjen e aplikimit me ujë menjëherë pas përdorimit. Materiali i ngurtësuar mund të hiqet vetëm mekanikisht.

KUFIZIME

- Në raste derdhjeje dyshemesh që mund të tejkalojnë 50 mm trashësi, ju lutemi këshillohuni me departamentin tonë teknik.
- Përzierja duhet bërë gjithmonë me mjete mekanike: përzierja manuale nuk lejon arritjen e punueshmërisë optimale.
- Mos shtoni ujë tek llaçi pas përzierjes.
- Ruani lagështinë dhe mbroni sipërfaqen e llaçit të aplikuar për të paktën 24 orë pas aplikimit.
- Në rast derdhjeje dyshemesh, sidomos në mjedise të jashtme, shmangni tharjen shumë të shpejtë të produktit në ditët e para të maturimit.
- Mbroni produktin e aplikuar nga veprimi i rrezatimit të drejtpërdrejtë diellor dhe era në orët e para të maturimit dhe ngurtësimit të produktit.
- Mos derdhni dysheme në kushte të këqija moti, të cilat mund të zgjasin deri në fazat e para të maturimit, si p.sh. kur pritet shi apo ngrica, erë e fortë, rrezatim i drejtpërdrejtë diellor, etj.

BAZA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Të gjitha të dhënat teknike që deklarohen në këtë fletë me të dhënat e produktit bazohen mbi prova laboratorike. Të dhënat reale të matura mund të ndryshojnë për shkak të kushteve që nuk janë nën kontrollin tonë.

KUFIZIME LOKALE

Ju lutemi të keni parasysh se si rezultat i rregulloreve të posaçme lokale performanca e këtij produkti mund të variojë nga një shtet në tjetër. Ju lutemi, këshillohuni me fletën e të dhënave të produktit (botimin lokal) për të dhënat e sakta të produktit.

EKOLOGJI, SHËNDET DHE SIGURI

Për informacione dhe udhëzime rreth përdorimit, magazinimit dhe asgjësimit të sigurt të produkteve kimike, përdoruesit duhet t' i referohen Fletës me të Dhënat e Sigurisë (Safety Data Sheet, SDS) më të fundit, e cila përmban të dhëna fizike, ekologjike, toksikologjike dhe të tjera që lidhen me sigurinë gjatë përdorimit të produktit.

SHËNIME LIGJORE

Informacionet dhe në veçanti sugjerimet që kanë të bëjnë me aplikimin dhe përdorimin përfundimtar të produkteve të Sika-s, ofrohen me mirëbesim dhe bazohen mbi njohuritë aktuale dhe përvojën e kompanisë për produktet kur ato magazinohen, përdoren dhe aplikohen nën kushte normale në përputhje me sugjerimet e Sika-s. Në veprim e sipër, dallimet tek materialet, nënshtrësat dhe kushtet lokale të aplikimit, janë të tilla sa që asnjë garanci nuk mund të jepet në lidhje me tregtimin apo përshtatshmërinë e tyre për një synim konkret dhe nuk mund të ngarkohet asnjë përgjegjësi nga e cila mund të krijohet çfarëdolloj afere ligjore kundër kompanisë në bazë të informacioneve që përmenden këtu, sugjerimeve me shkrim apo informacioneve të dhëna në çfarëdolloj forme tjetër. Përdoruesit e produkteve duhet të kontrollojnë përshtatshmërinë e tyre për çdo aplikim dhe qëllim përdorimi. Sika ruan të drejtën e ndryshimit të vetive të produkteve të saj. Ruajtja e të drejtave të personave të tretë është e detyrueshme. Të gjitha porositë pranohen sipas kushteve të kompanisë rreth shitjes dhe dorëzimit. Përdoruesit e produkteve duhet gjithnjë të referohen në botimin më të fundit lokal të fletës me të dhënat e produktit, kopjet e të cilave do të jepen sipas kërkesës.

Sika Albania SHPK

Rruga e Rinasit, Tirana Business Park
Ndërtesa nr. 7, kati 4
Tiranë - Shqipëri
Tel.: +355 4 454 0070
alb.sika.com
Email: info@al.sika.com



Fleta e të dhënave të produktit
Sika® Patch-5
Shtator 2019, Botimi 04.01
020302040040000008

SikaPatch-5-sq-AL-(09-2019)-4-1.pdf

